



## THIRRJE PËR APLIKIM

### Mbështetje për Bizneset Lokale në Komunën e Shtërpçës

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), në partneritet me Komunën e Shtërpçës, fton bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Shtërpçës të aplikojnë për pjesëmarrje në aktivitetet e mbështetjes për zhvillimin e biznesit që zbatohen në kuadër të Programit të Qëndrueshmërisë Ekonomike (ERP).

Programi i Qëndrueshmërisë Ekonomike synon të forcojë zhvillimin ekonomik lokal duke mbështetur ndërmarrësinë, rritur konkurrueshmërinë e bizneseve, nxitur inovacionin dhe kontribuar në krijimin e vendeve të qëndrueshme të punës.

Bizneset e përzgjedhura do të përfitojnë mbështetje të përshtatur për zhvillimin e biznesit përmes metodologjisë In Motion ose Growing Your Business (GYB), varësisht nga madhësia, niveli i zhvillimit dhe nevojat e biznesit të identifikuar gjatë procesit të vlerësimit. Mbështetja do të përfshijë diagnostikimin e biznesit, mentorim, këshillim, shërbime konsulence dhe, në varësi të burimeve të programit dhe nevojave të identifikuar gjatë zbatimit, mbështetje me mjete dhe pajisje.

Metodologjia In Motion është e dedikuar kryesisht për mikro-ndërmarrjet dhe bizneset në fazat e hershme të zhvillimit, ndërsa metodologjia Growing Your Business është e dizajnuar për ndërmarrje më të konsoliduara me potencial të dëshmuar për rritje.

Programi synon të mbështesë deri në dhjetë (10) mikro-ndërmarrje përmes metodologjisë In Motion dhe deri në katër (4) ndërmarrje të vogla dhe të mesme përmes metodologjisë Growing Your Business (GYB).

### KRITERET E PRANUESHMËRISË

Kjo thirrje për aplikim shërben për para-kualifikimin dhe vlerësimin fillestar të bizneseve të interesuara për pjesëmarrje në Programin e Qëndrueshmërisë Ekonomike (ERP). Dorëzimi i aplikacionit nuk garanton përzgjedhjen në program. Vetëm aplikuesit që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë dhe vlerësimit mund të përzgjidhen në listën e ngushtë për vlerësim të mëtejshëm, përfshirë vizitat në biznes dhe intervistat.

#### Aplikuesit duhet:

- Të jenë të regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK);
- Të ushtrojnë aktivitetin e tyre në mënyrë aktive brenda territorit të Komunës së Shtërpçës;
- Të zhvillojnë aktivitetet e biznesit në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Të demonstrojnë përkushtim dhe gatishmëri për të marrë pjesë aktivisht gjatë gjithë periudhës së zbatimit të programit;
- Të lejojnë vlerësime të biznesit, aktivitete monitorimi dhe vizita në terren të realizuara nga UNDP dhe Komuna e Shtërpçës.

### GRUPET PRIORITARE

**Vëmendje e veçantë do t'u kushtohet:**

- Bizneseve në pronësi dhe menaxhim të grave;
- Bizneseve në pronësi të rinjve (18–35 vjeç);
- Bizneseve në pronësi ose menaxhim të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë;
- Bizneseve në pronësi të personave me aftësi të kufizuara (kur është e aplikueshme);
- Bizneseve fillestare (start-up) dhe bizneseve të sapokrijuara me potencial të dëshmuar për rritje;
- Bizneseve me potencial për krijimin e vendeve të reja të punës;
- Bizneseve që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal dhe qëndrueshmërinë e komunitetit.

## PROCESI I PËRZGJEDHJES

Aplikacionet do të shqyrtohen nga një Komision Vlerësues i përbërë nga përfaqësues të UNDP-së, Expertë të fushës dhe Komunës së Shtërpçës.

Procesi i përzgjedhjes do të përfshijë:

- Shqyrtimin administrativ të aplikacioneve;
- Vlerësimin teknik të aplikacioneve të pranueshme;
- Përzgjedhjen e listës së ngushtë të aplikuesve;
- Vizita në biznes dhe intervista;
- Përzgjedhjen përfundimtare të përfituesve.

UNDP rezervon të drejtën të krijojë një listë rezervë të aplikuesve të kualifikuar.

Bizneset e përzgjedhura në listën e ngushtë pas vlerësimit fillestar do të vizitohen në lokacionet e tyre nga përfaqësues të UNDP-së dhe Komunës së Shtërpçës. Qëllimi i vizitës është verifikimi i informatave të paraqitura në aplikacion, vlerësimi i operimit të biznesit dhe identifikimi i metodologjisë më të përshtatshme të mbështetjes për biznesin.

Dorëzimi i aplikacionit nuk garanton përzgjedhjen për pjesëmarrje në program. Vetëm aplikuesit e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

## DOKUMENTET E NEVOJSHME

Aplikuesit duhet të dorëzojnë:

- Fotografi ose kopje e Certifikatës së Regjistrimit të Biznesit (ARBK)
- Fotografi ose kopje e letërnjoftimit të pronarit ose përfaqësuesit të autorizuar
- Së paku një (1) fotografi e brendshme e biznesit
- Së paku një (1) fotografi e jashtme e biznesit

Aplikacionet e paplotësuara, aplikacionet e dorëzuara pas afatit, ose aplikacionet që nuk përmbajnë dokumentacionin e kërkuar përcjellës do të diskualifikohen dhe nuk do të merren parasysh gjatë procesit të vlerësimit.

## AFATI I APLIKIMIT

Aplikacionet duhet të dorëzohen jo më vonë se **8 korrik 2026, deri në orën 16:00**.

Aplikacionet mund të dorëzohen në mënyrë elektronike përmes linkut të mëposhtëm:

[APLIKO](#)